



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
NJËSIA E PROKURIMIT**

Maliq më _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

” Blerje karburant (gazoil+benzinë) per mjetet e bashkisë + ngrohje shkolle”

Në mbështetje të Ligjit Nr.162,datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 55 “Procedure e hapur e thjeshtuar”, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu IX “Rolet dhe Përgjegjësitë në Autoritetin/Entin Kontraktor”, Neni 73, “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike” dhe Urdhërit të Prokurimit **Nr.24 datë 17.03.2025** të Kryetarit të Bashkisë Maliq, Njesia e Prokurimit e ngritur me **Urdhër Nr.160, datë 17.03.2025** “Për ngritjen e Njesisë së prokurimit” mbledhur sot në datë **28.03.2025** morri në shqyrtim dokumentet e tenderit me objekt: **“Blerje karburant (gazoil + benzine) per mjetet e bashkise + ngrohje shkolle”**

A - Për këtë në bazë të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, u hap faqja e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik nga ku u morrën dokumentat standarte të tenderit. Këto dokumenta u përzgjedhën për procedurën e përcaktuar në Urdherin e Prokurimit Nr.1 datë 19.03.2025 dhe u procedua si më poshtë:

1. U plotësuan dokumentat e tenderit të mësipërm sipas Dokumentave Standarte të tenderit dhe u përgatitën për hedhjen në sistem.
2. Kërkesat e Përgjithshme për kualifikim të mbeten ato që përcaktohen në Dokumentat Standarte.
3. Kërkesat e veçanta për kualifikim të vendosen si më poshtë:
4. Për përllogaritjen e fondit limit, AK i është referuar kontratave të mëparshme si dhe sasisë së pritshme të nevojshme për të mbuluar nevojat e Autoritetit Kontraktor, për vitin kalendarik 2025.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq** ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohej për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohej për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Jane ato të paraqitura në DST dhe nuk ndryshojnë nga njesia e prokurimit

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Vetëdeklarimi sipas KRITEREVE TË PERGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT.

Argumentimi: kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit të vitit 2022, 2023, 2024, të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin

financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme , nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Kriteret e kërkuara në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2. janë vendosur me qëllim që të vërtetohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës.

2.2.2 Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2022, 2023,

2024) nga data e publikimit të tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë një vlerë jo më të vogël se 30% të vlerës së fondit limit që prokurohet,

Argumentimi:Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 "Mbi Rregullat e Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, për vitin 2025 , pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar dhe për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse,

bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

*** Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.**

Argumentimi: Bazuar ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, operatori ekonomik duhet te vertetoje se nuk ka deturime tatimore te pa shkyera ne njesite e qeverisjes vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera (realizuara) gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit, me një vlerë jo më të vogël 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do

ta vërtetojë duke paraqitur :

- Kontratën e nënshkruar me institucionin,
- Vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.
- Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur:
 - Faturën përkatëse tatimore ku të jetë shënuar data, shuma, sasia e mallrave të furnizuara, të nënshkruar nga të dyja palët

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Subjekti ofertues duhet te paraqese listen e stacioneve te shitjes se karburanteve me pakice vertetuar me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronesisë ose te jene te pasqyruara ne ekstraktin e QKB, etj) per stacionet, detyrimisht qe nga 01 janari 2025 e ne vazhdim.

Keto stacione te jene te pajisura me

- vertetim teknik nga ISHTI,
- Akt -Teknik nga PMNZH,
- Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, per distributoret e shitjes me pakice.

2.3.3 Vërtetimin e pagesës së Tarifës për Dhënie Lejë 24 orë “Për karburante” pranë njësisë se qeverisjes vendore, te vlefshme per vitin kalendarik 2025.

Argumentim : Per te vertetuar se operatori ekonomik disponon leje per furnizimin e mjeteve ne cdo kohe kerkohet te jete i pajisur me leje per ushtrimin e aktivitetit, e vila duhet te vertetuar me pagesen e kryer prane njesise se qeverisjes vendore ku ushton aktivitetin.

2.3.4 Bazuar ne VKM Nr 561, date 29.07.2016, “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshme“, Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me sistemin e kartave elektornike të vërtetuar me kontratë shitje, instalimi, mirëmbajtje të sistemit të automatizimit dhe tollonave elektronike . Operatroi ekonomik duhet të pajisë mjetet e Autoritetit Kontraktor me Karta Elektronike për furnizimin me karburant te mjeteve.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST

2.3.5 Bazuar në VKM Nr.561 datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se ofron një ndërfaqe menaxhimi të karburanteve (WEB-page) që furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike për të gjitha pikat e furnizimit. Kjo ndërfaqe e menaxhimit të karburanteve (WEB page) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të karburantit nga Operatori ekonomik drejt AK-së dhe nga llogaria elektronike e AK –së në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizohet me targonë të mjetit si dhe administrimi i sasise të karburanteve të kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje dhe në zbatim me VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Kërkesa për disponimin e një website të furnitorit është e rëndësishme pasi furnizimi i karburantit me karte elektronike, transferimi i sasise të karburantit nga furnitor tek AK-ja bëhet në mënyrë elektronike, vetëm nëpërmjet website të furnitorit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me autobot të posaçëm për transport karburanti së bashku me aparatin matës

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar *i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike :*

të vërtetuar me :

- Certifikatë pronësie,
- Lejë qarkullimi e vlefshme
- Certifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
- Polia e sigurimit e vlefshme
- Certifikatë për transport mallrash të rrezikshme, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- Foto të mjetit dhe autobotit të posaçëm

Kur mjeti është me qira duhet të paraqesë :

- Kontrata e qirave të vlefshme për periudhën e furnizimit me karburant.
- Certifikatë pronësie,
- Lejë qarkullimi e vlefshme
- Certifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
- Polica e sigurimit e vlefshme
- Foto të mjetit dhe autobotit të posaçëm.

- **Certifikatë për transport mallrash të rrezikshme, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.**

Argumentimi: Per te vertetuar se operatori ekonomik disponon kapacitete per te furnizuar me karburant Autoritetin kontraktor sipas kërkeses se tij dhe per ta sjelle mallin prane AK per furnizimin e depozites se kaldajes kerlohet qe operatori ekonomik te disponoje mjet autobot i cili vertetohet me dokumentacionin e pronesise ku verteton se mjeti eshte i pajisur me te gjith dkumentacionin per te kryer furnizimin e kerkuar.

2.3.7 Subjekti ofertues duhet të paraqesë deklaratat si me poshte:

- Subjekti duhet te deklaroje se merr persiper furnizimin me karburant detyrimisht ne pistolete publike.*(Deklarate nga subjekti ofetues).*
- Subjekti duhet te deklaroje, se merr persiper furnizimin me karburant me mjetin e tij (bot) dhe shpenzimet e tij me sherbim 24 ore ne vendndodhjen e Autoritetit Kontraktor, sipas kërkesave te tij.*(Deklarate nga subjekti ofetues)*
- Subjekti duhet te deklaroje se merr persiper që kartat elektronike duhet te jene pa skadence dhe te konsumueshme edhe gjate vitit 2026. *(Deklarate nga subjekti ofetues).*
- Operatori ekonomik duhet te mbuloje furnizimin nepermjet karteve elektronike te personalizuar, sipas adresave te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor. *(Deklarate nga subjekti ofetues).*
- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë, me karte elektronike te personalizuar me targon e cdo automjeti te autoritetit kontraktor, dhe/ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor ne momentin e lidhjes se kontrates.
- Subjekti te deklaroje se faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) do te ofroje sherbimin e ngarkimit te sasise se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Subjekti te deklaroje se faqja e menaxhimit te karburanteve do te ofroje edhe sherbimin per krijimin e struktures piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit kontraktor, sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike, te cilat ngjiten ne xhamin e automjetit dhe ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate automjet per te eliminuar levizjen e mundshme te targave nga mjetit te shoqwrise drejt mjeteve private.

Mos ofrimi i sherbimeve te kerkuara me siper ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarres perben kusht per s'kualifikim.

- Ky kriter plotësohet me dorëzimin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Per kriteret e percaktuara ne Kapacitetin teknik, Njesia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr162,datë 23.12.2020, "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik" Sesioni III ,"Kërkesa te vecanta sipas tipeve te kontratave" neni 40" Kërkesa te vecanta per kontratat e mallrave".

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve: Gazoil (Nafte) D1

Nr.	Treguesit	Njesia e matjes	Kufijte	
			minimum	maksimum
1	Densiteti ne 15 °C	Kg/m3	820	845
2	Indeksiicetanit	-	46	-
3	Pika e flakerimit	°C	55	-
4	Distilimi			
a	Distilonderi ne 250° C	% vellim	-	65
b	Distilonderi ne 350 °C	% vellim	85	
c	50% e vellimitdistilon ne	°C	-	-
d	90% e vellimitdistilon ne	°C	-	-
e	95% e vellimitvlon ne	°C	-	360
5	Viskozitetikinematik ne 40°C	sSt(mm2/s	2,00	4,50
6	Permbajtja e squfurit	Mg/kg	-	10
7	Korrodioni ne baker	3 ore/50°C	Klasa I	

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Gazoili te jete brenda kushteve dhe normave teknike sipas standarteve te miratuara.
- Furnizimi per mjetet e Bashkise do te behet me Karte Elektronike.
- Gazoili para zbatimit te kontrates se furnizimit do te inspektohet nga zyra pergjegjese per administrimin e kontrates.

**Në rast se dokumentet e mësipërme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.*

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT